

Ftesë për pjesëmarrje në Tryezën e Këshillimit dhe Diskutimit për Kapitullin 22 “Politika Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore”

Në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga procesi i bashkënduar i Integritimit Evropian dhe, mbështetur në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 113, datë 30.08.2019, “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian”, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, si institucioni që vepron si Sekretariat Teknik i Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE), për Kapitullin 22 shpall njoftimin, “Ftesë për Pjesëmarrje”, drejtuar:

- Përfaqësuesve të pushtetit vendor
- Përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile
- Përfaqësuesve të biznesit
- Përfaqësuesve të shoqatave të punëmarrësve
- Përfaqësuesve të botës akademike
- Përfaqësuesve të medias
- Përfaqësuesve të grupeve të interesit

Përfaqësuesit si më sipër, ftohen për të qenë anëtarë të “Tryezës së Këshillimit dhe Diskutimit për Kapitullin 22 – “Politikat Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore”, e cila do të shërbejë si bazë diskutimi dhe shqyrtimi në lidhje me qëndrimet dhe rekomandimet për fushat që mbulohen sipas këtij Kapitulli.

Kapitulli 22, “Politikat Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore” i përket Klasterit “Burimet, bujqësia dhe kohezioni” dhe është një nga kapitujt kryesorë që vlerësohet me interes të lartë nga Qeveria e Shqipërisë pasi përcakton kornizën për pjesëmarrjen e ardhshme të Shqipërisë në Politikën e Kohezionit të BE-së dhe përfitimet e mëtejshme zhvillimore nga investimet e instrumenteve strukturore të BE-së.

Acquis sipas këtij Kapitulli përbëhet kryesisht nga politika kuadër dhe rregullore zbatuese, të cilat nuk kërkojnë transpozim në legjislacionin kombëtar. Ato përcaktojnë rregullat për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve të Fondeve Strukturore dhe të Kohezionit që pasqyrojnë organizimin territorial të çdo vendi.

Për tu bërë pjesë e tryezës së Këshillimit dhe Diskutimit për Kapitullin 22, duhet që brenda datës **28 Gusht 2023** të paraqitet nga ana e kandidatëve: a) Letër Interesi; b) Curriculum Vitae e personit dhe/ose Profilin e grupimit/organizatws që përfaqëson, duke treguar se kanë ekspertizën apo interesin e mjaftueshëm për të kontribuar në diskutimet e kësaj tryeze.

Dokumentet duhet të paraqiten në adresën: *Bulevardi “Zhan d’Ark”, ish-Shtëpia e Ushtarakëve* ose të dërgohen në adresën elektronike: amvv@mb.gov.al dhe ose kapitulli.22@mb.gov.al